

AKT NORMATIV
Nr. 26, datë 10.6.2020

PËR MARRJEN E MASAVE TË PËRKOHSHME PËR MBËSHTETJEN E
SEKTORIT TË TURIZMIT

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

1. Ky akt normativ ka për objekt përcaktimin e masave të veçanta që do të merren në sektorin e turizmit, për agjencitë e udhëtimit, operatorët turistikë dhe klientët e tyre, në ofrimin e një shërbimi udhëtimi, nga dita e shpalljes deri në përfundim të gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga COVID-19.

2. Për qëllime të këtij akti normativ, me termat e mëposhtëm nënkuptojmë:

a) “Klientë”, turistët dhe personat e tjerë, si individë apo të organizuar në grup, që i ofrohet çdolloj shërbimi udhëtimi, përfshirë akomodimin në struktura pritëse për turistët, këshillim dhe ofrim i shërbimeve të udhëtimit me ajër, me tokë e me det, të ekskursioneve të organizuara, si dhe një sërë shërbimesh të tjera ndihmëse, që lidhen me industrinë e turizmit;

b) “Rimbursim”, lëshimi i një kuponi (*voucher*) që korrespondon me të njëjtin shërbim, i cili i korrespondon vlerës/shumës totale të paguar/rezervuar ose vlera/shuma totale që duhet t'i kthehet klientit për shërbimin e parapaguar ose të rezervuar, sipas parashikimeve të këtij akti normativ;

c) “Shërbim i rezervuar”, një pjesë e pagesës që klienti ka kryer në momentin e rezervimit të shërbimit të udhëtimit.

Neni 2

Ky akt normativ ka për qëllim mbështetjen e sektorit të turizmit, për subjektet e përcaktuara në nenin 1, të këtij akti normativ, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, duke ofruar një balancim dhe siguri ekonomike në funksion të përmbushjes së kërkesave të klientëve, në një mjedis të sigurt, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga COVID-19, në përputhje edhe me parashikimet e nenit 488 e në vijim, të Kodit Civil.

Neni 3

Operatorët turistikë apo agjencitë e udhëtimit, të cilët, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose si ndërmjetës, kanë marrë përsipër t'u ofrojnë klientëve çdolloj shërbimi udhëtimi apo një sërë shërbimesh të tjera ndihmëse, dhe këto shërbime janë të parapaguara ose të rezervuara përpara shpalljes dhe gjatë gjendjes së fatkeqësisë natyrore, përjashtimisht detyrimeve të parashikuara shprehimisht në kontratë, të kryejnë rimbursimin e tyre, brenda 1 (një) viti nga hyrja në fuqi e këtij akti normativ.

Neni 4

Operatorët turistikë apo agjencitë e udhëtimit, që kanë lidhur kontrata ndërmjetësimi për shitjen e shërbimeve të ofruara nga furnizuesit e shërbimeve të udhëtimit me klientin dhe këto shërbime janë të parapaguara ose të rezervuara përpara shpalljes dhe gjatë gjendjes së fatkeqësisë

natyrore, përjashtimisht detyrimeve të parashikuara shprehimisht në kontratë, të kryejnë rimbursimin e tyre, brenda 1 (një) viti nga hyrja në fuqi e këtij akti normativ.

Neni 5

Klienti i një pakete udhëtimi apo dokumenti udhëtimi, nga/apo nëpërmjet agjencive të udhëtimit ose operatorit turistik, për shërbimet e udhëtimit të parapaguara përpara shpalljes dhe gjatë gjendjes së fatkeqësisë natyrore, përjashtimisht detyrimeve të parashikuara shprehimisht në kontratë, përfiton rimbursimin e tyre brenda 1 (një) viti nga hyrja në fuqi e këtij akti normativ.

Neni 6

1. Në rast të pamundësisë së realizimit të kontratave të transportit të klientëve me mjetet e transportit ajror, si pasojë e masave kufizuese të ndërmarra për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga COVID-19, nga/dhe aeroporti ndërkombëtar “Nënë Tereza”, Tiranë, transportit detar nga të gjitha portet në vend ose ujërave të brendshme, subjektet e parashikuara në nenet 3, 4 dhe 5, të këtij akti normativ, detyrohen të njoftojnë, sipas rastit, respektivisht agjencinë/transportuesin/akomoduesin ose organizatorin e paketave të udhëtimit/klientin për pamundësinë e zbatimit të kontratave të transportit, duke bashkëlidhur dokumentacionin që vërteton dokumentin e udhëtimit ose rezervimin e qëndrimit ose kontratat e paketave të udhëtimit.

2. Ky komunikim bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga:

- a) hyrja në fuqi e këtij akti normativ, për shërbimet/kontratat, të cilave iu ka përfunduar afati;
- b) data e planifikuar e nisjes apo e mbërritjes, për shërbimet/kontratat brenda afatit.

Neni 7

1. Operatorët turistikë apo/ose agjencitë e udhëtimit, brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga komunikimi i përmendur në pikën 2, të nenit 6, të këtij akti normativ, të rimbursojnë dokumentin e udhëtimit dhe/ose paketën e udhëtimit nëpërmjet lëshimit të një kuponi (*voucher*), që korrespondon me të njëjtën vlerë/shumë totale që duhet të kthehet, duke i ofruar klientit mundësinë e përdorimit të kuponit për të njëjtin shërbim ose një të ngjashëm, që i përket kontratës së ndërprerë, e cila do të përdoret brenda 1 (një) viti.

2. Në rast se nuk realizohet shërbimi, sipas parashikimeve të pikës 1, të këtij neni, operatorët turistikë apo/ose agjencitë e udhëtimit t'i rimbursojnë klientit vlerën/shumë totale të paguar.

Neni 8

1. Dispozitat e mësipërme zbatohen në rastet kur shërbimi i udhëtimit është objekt transaksioni nga/dhe agjencitë e udhëtimit dhe operatorët turistikë, vendas apo të huaj, që zhvillojnë veprimtarinë turistike sipas legjislacionit në fuqi.

2. Ky akt normativ, në çdo rast, nuk ka për qëllim kufizimin e të drejtave dhe të lirive të subjekteve të përcaktuara në nenin 1, të këtij akti normativ.

Neni 9

Operatorët turistikë apo/ose agjencitë e udhëtimit, të cilët nuk e zbatojnë këtë akt normativ, përveç përmbushjes së detyrimeve kontraktuale ndaj klientit, dënohen me gjobë, për çdo kontratë të parealizuar, sipas masës së parashikuar në shkronjën “dh”, të pikës 1, të nenit 71, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar.

Neni 10

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama